



Pranuar / Dorezuar Prilimjenal/Prodato Received/Delivered	26-07	3	viti viti year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	5370/2023		1/4



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.838/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.838/2023 të datës 13.06.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë pune në [redacted] kundër rezultateve të vlerësimit të Komisionit të Pranimit të Komunës së Obiliqit i datës 07.06.2023, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 26.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.838/2023 e datës 13.06.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] me datë 12.06.2023 përmes e-mailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil është regjistruar me datë 13.06.2023 nën shenjën A.nr.838/2023 dhe numër protokoli:4720/2023, kundër rivlerësimit të jetëshkrimit të datës 07.06.2023 nga Komisioni i Pranimit në Komunën e Obiliqit me pretendimin ankimore se Komisioni i Pranimit me rastin e vlerësimit të ankueses në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit nuk e ka rivlerësuar mjaftueshëm për të vazhduar në fazën e mëtutjeshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 15.06.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Obiliqit. Ndërsa me datën 20.06.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për shqyrtimin e kësaj ankese administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1968/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshill; E-mailin e datës 21.02.2023 dërguar nga ankuesja në Këshill; Vendimin Nr.XII/34 e datës 21.02.2023 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Obiliqit; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.03.2023; Përgjigjen në kërkesë e datës 20.03.2023; Konkursin e datës 29.11.2022; Listën e kandidatëve që kanë aplikuar; Njoftimin e datës 10.01.2023 lidhur me kandidatët që kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak; Vendimin për themelimin e Komisionit të Pranimit i datës 27.01.2023; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e datës 13.02.2023; Rezultatet e vlerësimit përfundimtar i datës 13.02.2023; Ankesën e ankues të parashtruar në Komisionin e Pranimit me datë 14.02.2023; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Aplikacionin e ankueses të datës 02.12.2023; Diplomën e datës 05.07.2013 me numër:69/13 lëshuar nga Kolegji Universitar Biznesi; Diplomën e datës 20.06.2016 me numër:23/16 lëshuar nga Kolegji Universitar Biznesi; Çertifikatën e datës 15.012.2015 lëshuar nga IAS Consulting; Kontratën e punës së ankueses (data e pa lexueshme); referencën e datës 01.07.2012; Pasqyrën e llogarisë së trustit e datë 01.12.2021; Çertifikatën e lëshuar nga Gjykatat Themelore në Prishtinë-Dega Prishtinë e datës 02.12.2022; Formularët e vlerësimit të jetëshkrimit për të gjithë kandidatët; Vendimi me numër A.nr.389/2023 i datës 07.04.2023; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar KPMSHCK e datës 28.04.2023; Vendimi i Komunës së Obiliqit me numër -II-509 i datës 25.04.2023; Ankesa e ankueses e datës 13.06.2023 me numër të protokollit 4720/2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.06.2023; Përgjigja në ankesë e datës 20.06.2023; Rezultatet e vlerësimit të M.B; Rezultatet e vlerësimit të S.R; Rezultatet e vlerësimit të T.B; Rezultatet e vlerësimit të U.G; Rezultatet e vlerësimit të A.P; Rezultatet e vlerësimit të F.L; Rezultatet e vlerësimit të F.J; Rezultatet e vlerësimit të I.G; Rezultatet e vlerësimit të L.H.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e *palejuar*, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja [redacted] kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil me datën 22.02.2023 e cila ka marrë shenjen A.nr.389/2023, lidhur me vlerësimin e jetëshkrimit nga Komisioni i Pranimit në Komunën e Obiliqit për pozitën "Asistent administrativ 3" në kuadër të Sektorit të Arsimit të Komunës së Obiliqit, ndërsa Kolegji i Këshillit ka gjetur se në konkursin e shpallur ka aplikuar edhe ankuesja e cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, ashtu që në testin me shkrim kishte arritur 47 pikë, ndërsa për jetëshkrimin është vlerësuar me gjithsejtë 9.6 pikë dhe si rrjedhojë nuk kishte arritur të grumbulloi gjithsejtë 60 pikë sa është e nevojshme për të iu nënshtruar edhe intervistës me gojë.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të pretendimit të ankueses se vlerësimi i jetëshkrimit nuk ka qenë i drejtë, me datë 07.04.2023 kishte nxjerr Vendimin A.nr.389/2023 me numër të protokollit 3430/2023 duke e aprovuar ankesën e ankueses dhe njëherit ka kthyer procedurën e rekrutimit sipas Konkursit RN00010509 të datës 29.11.2022 në rishqyrtim në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit të kandidatëve tek Komisioni i Pranimit.

Tutje, Komuna e Obiliqit, gjegjësisht Komisioni i Pranimit me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit ka rivlerësuar edhe njëherë jetëshkrimin e ankueses duke e vlerësuar të njëjtën me 10.67 pikë të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të vazhduar në fazën e më tutjeshme të konkursit. Ankuesja e pakënaqur me vlerësimin e Komisionit të Pranimit me datën 13.06.2023 ka parashtruar

ankesë të re drejtpërsëdrejti në Këshill e cila është regjistruar me numër A.nr. 838/2023 me pretendimin ankimor se vlerësimi i CV nuk ka qenë i duhur nga Komisioni i Pranimit.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe lejueshmërisë së shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me procedurën e rekrutimit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës nenin 31 paragrafi 1 dhe 2 ku përcaktohet se: *“Kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil, i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në vijim në tekstin e kësaj Rregullore “Këshilli”). 2. Ankesa në Këshill parashtrohet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës të organit përkatës që ka nxjerrë aktin apo kryer veprimin që kundërshtohet”.*

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankuesja [redacted] pas nënshtrimit të rivlerësimit të jetëshkrimit nga Komisioni i Pranimit edhe pse e pakënaqur me vlerësimin nuk ka parashtruar ankesë të brendshme pran Komisionit të Pranimit, andaj Kolegji në mbështetje të nenit 31 paragrafi 3 dhe 4 nën paragrafi 4.2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“3. Në rastin e pakënaqësisë ndaj procedurës apo rezultatit të konkurimit, pavarësisht nga faza me të cilin kandidati është i pakënaqur, ankesa parashtrohet ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje. 4. Ankesa ndaj aktit të përfundimit të procedurës të konkurimit, sipas paragrafit 3 të këtij neni, mund të paraqitet vetëm pas shterimit të procedurës të brendshme të ankesës. Procedura e brendshme e ankesës, vlerësohet së është shteruar nëse: 4.2. kandidati i pakënaqur me rezultatet e vlerësimit përfundimtar, ka parashtruar ankesën e brendshme sipas paragrafit 6 të nenit 25 të kësaj rregulloreje”* ka konstatuar se ankesa e ankueses e parashtruar me datë 13.06.2023 në Këshill është e palejueshme në rrethanat e rastit konkret, pasi që e njëjta nuk ka parashtruar ankesë kundër aktit përfundimtar, siç përcaktohet me paragrafin 6 të nenit 25 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës, ndërlidhur me paragrafin 1 dhe 5 të nenit 25 të së njëjtës rregullore ku parashihet se: *“1. Komisioni i Pranimit, në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton aktin e përfundimit të procedurës të konkurimit me fitues që përfshin edhe një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda ditës pasuese të punës nga miratimi i saj; 5. Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual”.*

Po ashtu, Kolegji njëzëri konstaton se meqenëse ankuesja nuk ka ofruar asnjë dëshmi të provueshme se e njëjta pavarësisht parashtrimin të ankesës në Këshill të ketë parashtruar ankesë të brendshme kundër vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, ankesa e ankueses është e palejueshme ngase vlerësimi i jetëshkrimit nuk llogaritet akt përfundimtar i përfundimit të procedurës së rekrutimit në kuptim të nenit 31 paragrafi 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj, pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe peshimit të secilës provë në procedurë të shqyrtimit të ankesës së ankuesit në mbështetje të nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Para parashtrimin të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”* ankesa e ankueses vlerësohet të jetë e palejuar në këtë fazë të procedurës.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur i cili pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.838/2023

**Flakron Gashi**

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

**Eshref SHABANI**

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.